



Agjencia Kombëtare
e Mjedisit

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (Sh.Gj.Sh.)

dhe

Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (A.K.M.)

Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në vijim, "Palët", duke konsideruar si objektiv kryesor rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellët ndërmjet dy institucioneve në fusha me interesa të përbashkëta mjedisore dhe realizimin e kontratave të monitorimit, duke u bazuar në:

1. Ligjin, Nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 568 datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizmin dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" si dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr. 23, datë 03.02.2020 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"
2. Ligjin, Nr. 111/2015, datë 15.10.2015, "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar";
3. VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit", kapitulli III "Zbatimi i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit nga organet qendrore dhe institucionet monitoruese", Pika 5 "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nëpërmjet Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, monitoron pikat B 1-ç; B4.3-a, b, c, ç, d, dh, e; C4-a, b, c; C5-a, b, ç; C6-e; e Ç11";
4. Në mbështetje të Rregullores "Për Funksionimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar", të miratuar me Urdhër Nr. 88, datë 22.02.2016, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Agjensia Kombëtare e Mjedisit

Kanë rënë dakord të lidhin këtë "Memorandum Bashkëpunimi" me përbajtje si më poshtë vijon:



Neni 1

Qëllimi i Memorandumit

Qëllimi i këtij Memorandumi është rritja e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet dy institucioneve në fusha me interesa të përbashkëta mjedisore.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

1. Fushat e dakordesuara te bashkëpunimit përfshijnë ujerat nëntokësore, zonën bregdetare dhe pranëdetare, dhe çdo fushe tjeter te përfshirë brenda fushës se ekspertizës se dy institucioneve
2. Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:
 - a) Shkëmbimit të informacionit dhe publikimeve nga secila pale;
 - b) Bashkëpunimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare me interes të dyanshëm;
 - c) Lidhjes së kontratave të shërbimit mes Palëve për monitorimet ne mjedis si detyrim ligjor i dyanshëm;
 - d) Pjesëmarres se përbashkët ne seminare, workshope, trainime apo aktivitete me interes te përbashkët;
 - e) Njoftimi dhe informimi midis palëve për aplikime me interes të përbashkët, por edhe për sejçilen palë.

Neni 3

Roli dhe përgjegjësitet e Palëve

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është përgjegjës për:

1. Zbatimin e VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit", kapitulli III "Zbatimi i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit nga organet qendrore dhe institucionet monitoruese", Pika 5 "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës, nëpërmjet Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, monitoron pikat B 1-ç; B4.3-a, b, c, ç, d, dh, e; C4-a, b, c; C5-a, b, ç; C6-e; e Ç11" ne varësi te financimit prej AKM;
2. Përcaktimin e kushteve teknike te stacioneve të monitorimit, propozimin për shtimin ose pakësimin e tyre;
3. Propozimin për percaktimin e parametrave mjedisor qe do te analizohen, shtimin/pakësimin apo ndryshimin e tyre sipas fushës se ekspertizës;
4. Propozimin për përcaktimin e frekuencës dhe dendurisë së monitorimit;
5. Vënien në dispozicion të të dhënavë të monitorimit AKM-së;



Agjencja Kombëtare e Mjedisit është përgjegjës për:

Zbatimin e VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit";

2. Përcaktimin e pikave apo stacioneve qe do te monitorohen;
3. Përcaktimin e parametrave mjedisore qe do te analizohen
4. Përcaktimin e frekuencës dhe dendurisë se monitorimit;
5. Financimin e monitorimeve sipas VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit";
6. Financimin e çdo projekti apo iniciative të iniciuar nga A.K.M. bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Palët bien dakord që rezultatet e kërkimeve, i gjithë informacioni i rëndësishëm dhe njohuritë e fituara prej projekteve të përbashkëta do të shpërndahen e publikohen ose do të mbahen konfidenciale në përputhje me termat specifikë të caktuara nga të dyja palët për projekte të veçanta. Kjo mënyrë veprimi dhe mbrojtja e pronësisë intelektuale duhet të jenë në përputhje me legjislacionin Shqiptar, në fuqi.

Neni 4

Gjuha e komunikimit

Gjuha e komunikimit dhe shkembimit te informacionit është gjuha shqipe.

Neni 5

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbujnë çdo informacion të nevojshëm për përbushjen e detyrave të tyre, sipas kushteve të paracaktuara. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike;
2. Shkëmbimi i informacioneve do të bëhet në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 6

Burimet e Financimit

1. Në rast bashkëpunimi në projekte kombëtare ose ndërkombëtare financimi do të bëhet nga financuesi apo drejtuesi i projektit, ku secila pale merr përgjegjësitet dhe angazhimet e veta me shkrim. Palët mund te aplikojnë sëbashku ne këto raste edhe si një pale e vetme.
2. Në rast kontrate shërbimi për monitorime te parametrave mjedisore financimi i tyre do të bëhet nga AKM, ndërsa ShGjSH do te vendos në dispozicion të kontratave burime njerëzore (specialistë te fushës, etj), infrastrukturën që disponon si Laboratorë dhe logjistike, por të gjitha kostot do ti perballoj pala që inicion ose kerkon sherbimim apo studimin. Shërbimi Gjeologjik ka te drejtën e përdorimit te rezultateve pa pagesë.

Neni 7

Përllogaritja e kostove



Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që palët kanë në dispozicion.

Neni 8

Periudha e raportimit

Në rast bashkëpunimi me kontrata shërbimi periudha e raportimit përcaktohet nga AKM në dakortësi me SHGJSH brenda vitit ushtrimor buxhetor ose në përfundim te Kontratave respektive.

Neni 9

Vlerësimi i zbatimit të Memorandumit

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht funksionimin e bashkëpunimit në mbështetje të Memorandumit nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes se raporteve periodike pranë titullarëve të Palëve.
2. Raporti periodik përmban, krahas të dhënave për mënyrën e zbatimit të Memorandumit, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 10

Ndryshimi i Memorandumit

Ky Memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 11

Përfundimi i Memorandumit

1. Memorandumi lidhet pa afat, por mund të përfundojë në çdo kohë me kërkesën me shkrim te secilës palë 30 dite përpala përfundimit.
2. Deri në përfundim të këtij Memorandumi, palët i përbahen kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, për sa i përket informacionit, shërbimeve të ofruara dhe dokumentacionit të shkëmbyer përpala datës së përfundimit.
3. Pavarësisht përfundimit të Memorandumit kontratat e nënshkruara zbatohen deri në përfundimin e tyre.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim mes Palëve, kur nuk zgjidhen me mirkuptim, palët kanë të drejtë të ndjekin rrugen gjyqësore.

Neni 13

Hyrja në fuqi



- Palët marrin aprovimin e Ministrive përkatëse për këtë Memorandum;
- Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet nga Palëve; Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje originale, 2 (dy) kopje depozitohen në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, 2 (dy) kopje depozitohen në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Ky Memorandum nënshkruhet sot në Tiranë, me datë 30/05/2022.

PËR

SHËRBIMIN GJEOLGJIK SHQIPTAR

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

VIKTOR DODA



PËR

**AGJENCINË KOMBËTARE TË
MJEDISIT**

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

